



Datë: 16.03.2026
Numër protokolli: 1373/2026
A.nr.924/2022
A.nr.923/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2868/2022 të datës 29.05.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.924/2022, të datës 30.11.2022, të parashtruar nga ankuesi A.H, të cilin me autorizimin e përfaqëson Avokat Faton Fetahu, me adresë: Sheshi “Nëna Terezë”, Nr.20, Komuna Prishtinë, kundër Vendimit me numër prot:3474 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 02.09.2022, në çështjen juridike “*Ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e nisur sipas ankesës A.nr.924/2022, e datës 17.10.2022, të parashtruar nga ankuesi A.H.

A r s y e t i m

Ankuesi A.H, përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 13.10.2022 përmes poste ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar me datë 17.10.2022 me numër protokolli 6241/2022, kundër Vendimit Nr.ref.533/2022 të datës 31.08.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale dhe procedurave ligjore, vendim të cilin sipas shkresave të lëndës është konstatuar se i njëjti e ka pranuar me datë 14.09.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në MPJD. Këshilli, me datë 01.11.2022 me numër protokolli:6605/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit për vendosje administroi këto prova: Ankesën e datës 17.10.2022, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 28.09.2022; Vendimin e datës 31.08.2022 e Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme; Shkresa e librit të protokollit e datës 14.09.2022; E-mailin ne datës 28.01.2012 dërguar nga Zyra e Personelit për ankuesin; E-mailin e datës 02.06.2012 dërguar nga Zyra e Personelit për ankuesin; Vendimin për emërimin e ankuesit dhe caktimin e gradës diplomatike i datës 05.07.2013 i nxjerr nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 30.12.2015 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 14.03.2016 të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin Nr.39/2018 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 13.07.2018 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 27.03.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; E-mailin e datës 03.05.2020 dërguar nga ankuesi për A.P; Vendimin e datës 14.05.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 30.06.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 10.07.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin për sistemimin të përhershëm i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD; Akt emërimin e ankuesit të datës 19.02.2021 me numër AE.nr.03/2021; Vendimin e datës 12.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 07.03.2022 për lejimin e pushimit pa pagesë lëshuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; E-mailin e datës 29.07.2022 dërguar nga ankuesi për A.B; E-mailin e datës 06.09.2022 dërguar nga ankuesi për A.B; E-mailin e datës 08.09.2022 e dërguar nga ankuesi për A.B; Zarfën postar i datës 13.10.2022 me numër R2482154; Përgjigjen në ankesë e datës 01.11.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së për Këshillin; Kërkesën për punësim të ankuesit i datës 22.08.2011; Listën e kandidatëve aplikues për misione konsullore i periudhës Gusht 2011; Listën e kandidatëve aplikues për misione diplomatike i periudhës Gusht 2011; Vendimin e datës 21.07.2011 për shpalljen e konkursit; Vendimin e Këshillit A.nr.924/2022 i datës 30.11.2022; Aktgjykimin A.nr.2868/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 29.05.2024; Ankesën e datës 09.07.2024 të parashtruar në Gjykatën e Apelit të Kosovës; Aktgjykimin AA.nr.652/2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 20.01.2026; Vendimin e Këshillit A.nr.924/2022 i datës 30.11.2022; Aktgjykimin A.nr.1346/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 05.04.2023; Aktgjykimin AA.nr.398/2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 11.07.2024; Aktgjykimin ARJ.nr.138/2024 të Gjykatës Supreme në Prishtinë të datës 21.01.2025; Aktvendimin Nr.ref:RK 2730/2025 i Gjykatës Kushtuese i datës 21.07.2025.

Kolegji i Këshillit, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore si dhe ekzistojnë rrethana të reja të cilat e plotësojnë kushtin që vendimmarrja për lëndën A.nr.924/2022 të ankuesit A.H të **pezullohet**, sepse:

Nga analizimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar se Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme me Vendimin Nr.140/11 të datës 21.07.2011 ka miratuar shpalljen e konkursit për përfaqësues diplomatik dhe konsullor në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim, Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.07.2011 shpall Konkursin për drejtues dhe nëpunës të tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi. Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton së lidhur me këtë procedurë konkurrimi ishte organizuar vetëm testimi i gjuhëve të huaja dhe intervista me gojë, dhe nga kjo fazë nuk ka dëshmi për vazhdimin e mëtejme të procesit të rekrutimit në fjalë, gjegjësisht pranimit të ankueses në pajtim me dispozitat e aplikueshme për shërbimin e jashtëm dhe shërbim civil.

Rrjedhimisht nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar se ankuesi bazuar në Vendimin Nr.Ref.383/13 të datës 05.07.2013 të Ministrit të Punëve të Jashtme emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke i'u caktuar grada diplomatike "*Sekretar i Parë*", dhe njëkohësisht i njëjti caktohet të shërbej në Misionin e Posaçëm të Republikës së Kosovës në Serbi duke filluar nga data 01.08.2022. Tutje, bazuar në provat e lëndës rezulton se ankuesi me Vendimin Nr.Ref:121/2016 të datës 30.12.2015 të Ministrit të MPJ-së i është ngritur grada Sekretar i Parë në Gradën Këshilltar, dhe është caktuar të vazhdojë misionin diplomatik si këshilltar në Misionin e Posaçëm në të Republikës së Kosovës në Serbi nga data 01.04.2016, pastaj ankuesi me Vendimin Nr.Ref:002/2016 të datës 14.03.2016 të Ministrit të MPJ-së, është caktuar të shërbejë si Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb/Kroaci, dhe po ashtu me Vendimin Nr.Ref:39/2018 të datës (*e palexueshme*) e vitit 2018 të Ministrit të MPJ-së, ankuesi i caktuar të shërbejë si Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb/Kroaci i vazhdohet mandati në shërbimin diplomatik në të njëjtin vend deri me datë 31.08.2018. Tutje, ankuesit me Vendimin Nr.Ref:569/2018 të datës 13.07.2018 të Ministrit të MPJ-së, i vazhdohet sërish mandati që të shërben në misionin diplomatik në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb/Kroaci deri me datë 31.07.2021, ndërsa Ministri i MPJD-së me datë 27.03.2020 nxjerrë Vendimin me Nr.Ref:105/2020 përmes të cilit ankuesin e tërheq nga shërbimi diplomatik në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb/Kroaci, duke e sistemuar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo Ministri i MPJD-së në lidhje me vendimin e apostrofuar më lartë ka nxjerrë Vendimin Nr.198/2020 të datës 13.05.2020 përmes të cilit e bënë shtyrjen e ekzekutimit të Vendimin me Nr.Ref:105/2020 deri me datë 30.08.2020. Po ashtu, Ministri i MPJD-së nxjerrë Vendimin Nr.259/2020 të datës 30.06.2020 përmes të cilit e bënë sërish shtyrjen e ekzekutimit të Vendimin me Nr.Ref:105/2020, ndërsa me datë 10.07.2022 Ministria e MPJD-së nxjerrë Vendimin Nr.344/2020 përmes të cilit ankuesin e tërheq nga misioni diplomatik duke ia mundësuar të njëjtit sistemimin dhe caktimin me detyra të punës në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe me qëllim të zbatimit të këtij vendimi Njësia e Burimeve Njerëzore e MPJD-së me datë 19.02.2021 ankuesit i lëshon Aktin e Emërimit me shifër AE.Nr.03/2021 duke e sistemuar ankuesin me kohë të pacaktuar në pozitën "*Zyrtar i Lartë për Marrëdhënie Dypalëshe*" në Departamentin për Çështje Rajonale.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Vendimin Nr.ref: 533/2022 të datës 31.08.2022 ka shfuqizuar Vendimin më numën reference 383/2013 të datës 05.07.2013 lidhur me emërimin e ankuesit në Shërbim e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe caktimin e gradës diplomatike Sekretar i Parë, ku edhe ishte caktuar të Shërbejë në Misionin e Posaçëm të Republikës së Kosovës në Republikën e Serbisë, mbi bazën ligjore se emërimi i ankuesit në shërbimin e jashtëm është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm, si dhe në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon së vendimi i kundërshtuar më ankesë karakterizohet me shkelje të dispozitave ligjore, shkelje formale-procedurale, dhe shkeljeve të ligjit material, konkretisht Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe akteve të tjera nënligjore që janë derivat i ligjeve të lartcekura.

Këshilli lidhur me ankesën e ankuesit të datës 17.10.2022, përmes Vendimit A.nr.924/2022 të nxjerrë me datë 30.11.2022 dhe numër protokolli:7503/2022 është shpallur jo kompetentë, pasi që Kolegji i Këshillit iu kishte referuar dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankueses në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi*, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik me të cilin parashihet: *Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor*, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstatuar se përveç të emëruarve politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civilë dhe së pranimi i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbim civil, andaj mbi këtë bazë ligjore, si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi ishte emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimit të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet se asaj kohe i njëjti ka themeluar marrëdhënie të punës në shërbim civil përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit ashtu siç përcaktohej me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin parashihej se: *Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil...*”, prandaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, konstatoi se Këshilli i Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ankuesi kundër Vendimit të Këshillit A.nr.924/2022 të datës 30.11.2022 kishte hapur konflikt administrativ, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.2868/2022 të datës 29.05.2024, e kishte aprovuar kërkesë padinë e palës paditëse, ndërsa e kishte anuluar vendimin e Këshillit, ndërsa çështjen e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura, me arsyetimin se akt i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e aplikuar nga neni 47 të LPPA-së, si dhe diapozitivi i aktit të kontestuar është i pasaktë dhe pa arsyetim, sikurse akti në fjalë nuk përmban elementet e detyrueshme të aktit siç përcaktohet me LPPA-së.

Këshilli, kishte parashtruar ankesën në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa kjo e fundit përmes Aktgjykimit AA.nr.652/2024 të datës 20.01.2026, (akt të cilën Këshilli e ka pranuar me datë 05.02.2026), ka refuzuar ankesën e Këshillit ndërsa Aktgjykimin A.nr.2868/2022 të datës 29.05.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative e ka vërtetuar.

Këshilli duke vepruar sipas obligime ligjore e ka aktivizuar lëndën, dhe lidhur me rastin ka analizuar edhe rastet e tjera të ngjashme në procedurë të konfliktit administrativ pasi që në Këshill në kohën sa ishin parashtruar disa ankesa nga zyrtarë të MPJD-së, e që rrethanat juridike, gjendja faktike dhe baza juridike e nxjerrjes së aktit të kontestuar në Këshill, ishte identike apo e njëjtë me rastin e ankuesit, respektivisht Kolegji i Këshillit përmes Vendimit me numër A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022 me shumicë votash kishte vendosur të shpallet jo kompetentë për të shqyrtuar ankesat e ankuesve: L. R, F. I, M.F, B. H, R. M, B. B, Sh. B, A. D, E. B dhe B. C, ndërsa për vendimin në fjalë njëri nga anëtarët e Kolegjit të Këshillit kishte paraqitur në formë të shkruar mendim mospajtues për natyrën e vendosjes i cili në Këshill është i evidentuar me shenjën A.nr.356/2022 i datës 10.06.2022 dhe numër protokolli:3386/2022. Andaj, bazuar në të dhënat me provat e bashkangjitura të dosjes së ankesave të ankuesve të bashkuara në ankesën A.nr.365/2022, dhe shkresave të lëndës së ankesës së ankuesit A.H A.nr.924/2022, Kolegji i Këshillit konstaton se arsyet e dhëna në vendimet e Zëvendës/Kryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të ankuesve të evidentuar sipas Vendimit të Këshillit me shenjën A.nr.365/2022 janë specifikisht të njëjta sikurse rrethanat faktike dhe baza ligjore mbi bazën e të cilave është nxjerrë Vendimi me numër Nr.ref.533/2022 i datës 31.08.2022 përmes të cilit ankuesit A.H i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Përfaqësuesit e autorizuar të palëve kundër Vendimit të Këshillit me numër A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022 kanë parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me datë 05.07.2022 ka nxjerrë Aktvendimin A.nr.1687/2022 përmes të cilit e ka shpallur vetën jo kompetent në pikëpamje të kompetencës lëndore, ndërsa pasi që i njëjti aktvendim të merr formë të prerë, lëndën do ta përcjellin në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Divizionit Civil, mirëpo përfaqësuesi i palëve paditëse kundër Aktvendimit A.nr.1687/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me datë 28.07.2022 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Gjykatat e Apelit të Kosovës përmes Aktvendimit 597/2022 të datës 25.08.2022 ka vërtetuar Aktvendimin A.nr.1687/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa e ka refuzuar ankesën e palëve paditëse. Palët paditëse kundër Aktvendimit A.nr.597/2022 të datës 25.08.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës kanë parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme, kurse kjo e fundit me datë 09.11.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me shifër ARJ-UZVP.nr.115/2022 përmes të cilit e ka prishur Aktvendimin A.nr.1687/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktvendimin A.nr.597/2022 të datës 25.08.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës ndërsa lëndën e ka kthyer për shqyrtim të mëtutjeshëm në shkallën e parë.

Duke vepruar sipas Aktgjykimit me shifër Arj-UZVP.nr.115/2022 të Gjykatës Supreme, të datës 09.11.2022, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 22.03.2023 ka nxjerrë Aktvendimin A.nr.1687/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes të cilit vendim e ka refuzuar kërkesën e palëve paditëse për mosekzekutimin e vendimit të Këshillit deri në nxjerrjen e vendimit merititor të procesit gjyqësor.

Tutje, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në shqyrtimin merititor, me datë 13.03.2025 ka marrë Aktgjykimin A.nr.1687/2022, përmes të cilit e ka aprovuar padinë e palëve paditëse, ndërsa e ka anuluar Vendimin e Këshillit A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022 përmes të cilit Këshilli ishte shpallur jo kompetentë, kurse lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli, kundër Aktgjykimit A.nr.1687/2022 të datës 13.03.2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës me datë 27.03.2025, ndërsa lënda është në proces të shqyrtimit në Gjykatën e Apelit, prandaj duke pasur parasysh se përmes Vendimit A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022, Këshilli ishte shpallur jo kompetentë për të shqyrtuar ankesat e ankuesve të cilëve iu ishte ndërprerë marrëdhënia së punës nga ana e Zëvendës/Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme, janë specifikisht të njëjta sikurse rrethanat faktike dhe baza ligjore mbi bazën e të cilave është nxjerrë Vendimi me numër Ref:533/2022 i datës 31.08.2022 përmes të cilit ankuesit A.H i është ndërprerë marrëdhënia e punës, andaj Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: ”çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”,** konstaton se ekzistojnë rrethanat të mjaftueshme që shqyrtimi i lëndës A.nr.924/2022 të pezullohet deri në vendosjen meritore nga Gjykata e Apelit të Kosovës, pasi që objekti i shqyrtimit (ndërprerja e marrëdhënies së punës duke iu referuar procedurave të rekrutimit sipas konkursit të datës 22.07.2011 të shpallur nga MPJ) respektivisht baza ligjore dhe rrethanat mbi të cilat është nxjerrë Vendimi i datës 31.08.2022 me Ref:533/2022 nga Zëvendës/Kryeministrja dhe Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë të njëjta dhe shërben si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore, gjithashtu Kolegji i Këshillit në këtë rast kishte parasysh edhe aktgjykimet e Instancave Gjyqësore që kishin vendosë në lidhje me rastin A.nr.301/2021 si dhe Aktvendimin për Papranueshmëri të

Gjykatës Kushtetuese në lidhje me rastin KI51/25 të datës 21.07.2025, por me qenë se në at rast ankesa e palës ishte e natyrës financiare (kërkesë për çështje të pagës) fillimisht në këshill, Këshilli kishte konstatuar se ankuesi nuk e ka fituar statusin e nëpunësit civil, dhe instancat gjyqësore kishin trajtuar edhe këtë elementë dhe kishin vendosë edhe në lidhje me këtë çështje, por me qenë se janë disa ankesa të së njëjtës natyrë dhe siç e potencuam më lartë tashmë në Gjykatë të Apelit është duke u trajtuar rasti A.nr.365/2022, andaj edhe është vendosë për pezullimin e kësaj lënde deri në përfundimin e rasteve që ndërlidhen me çështje të njëjtë.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, pas vendosjes së rastit nga instancat gjyqësore kompetente, sipas detyrës zyrtare do të aktivizojë dhe do të vendos edhe për lëndën A.nr.924/2022 të ankuesit A.H të datës 17.10.2022.

Bazuar në rrethanat e cekura si me lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit të provave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.923/2024, datë 16/03/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat Faton Fetahu;
- Luljeta Maxhuni, Gjyqtare në Departamentin për Çështje Administrative;
- Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.